



Datë 09.02.2026

Numri i vrojtimit të lejes:

07Nr.33/350-73121

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

Në bazë të nenit 21 të LPH nr.04/L-174 datë 31.07.2013, nenit 18 të LN nr.04/L-110 datë 31.05.2012, neni 13 paragrafi 4 pika 2 i UA-06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrënimi për kategorinë e I dhe të II të ndërtimeve, UA Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor datë 09.06.2017, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022 e që nuk është në kundërshtim me PZHK 2021-2029, 01Nr.016-67691 datë 29.10.2021, si dhe neneve 44, 47, 48 dhe 125 të LPPA Nr.05/L-031, DUPM në Suharekë lëshon këtë:

**AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)**

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Milazim Jashar Zeqiri	Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore 07Nr.350/73121 datë 04.12.2025
Emri i Projektit:	Objekt për Shërbime Shëndetësore dhe Shoqërore		
Emri i Projektuesit:	ArchiCOD		
Adresa:	Tirana PN, Prizren		
Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI, KATEGORIA II			
Adresa: Rr."Ereniku"- Suharekë, Komuna Suharekë			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
Çertifikata me Nr.3055-2026 datë 20.01.2026 pronë e Milazim Jashar Zeqiri	03055-1 643m²	Y= 7485597.998	X=4692178.744
		Y= 7485605.996	X=4692178.883
		Y= 7485606.217	X=4692166.185
		Y= 7485598.218	X=4692166.046
Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Objekt për Shërbime Shëndetësore dhe Shoqërore me etazhitet P+0			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria II			
Sipërfaqja:	(8.00m' x 12.70m') = 101.60 m²	Etazhiteti:	P+0
Vija rregullative:	Sipas Kushteve Ndërtimore 07Nr.630/350-62243 datë 27.10.2025	Vija ndërtimo	Sipas Kushteve Ndërtimore 07Nr.630/350-62243 datë 27.10.2025

Përshkrimi

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore Milazim Jashar Zeqiri nga fshati Mushtisht, Komuna Suharekë, për Leje Ndërtimore për ndërtimin e objektit për shërbime shëndetsore dhe shoqërore me etazhitet P+0. Lokacioni i objektit është në kuadër të Hartës Zonale të Komunës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, ku sipas gjendjes së planifikuar parcela kadastrale 03055-1 ZK Suharekë, është sipërfaqe Sub-Urbane ZB-3, me shfrytëzimet e lejuara të veçanta si shërbime shëndetësore. Objekti ka karakter të përhershëm, ndërtimi i objektit të bëhet konform projektit të pranuar nga DUPM e të nënshkruar me numër të Lejes Ndërtimore. Objekti është lejuar të ndërtohet me sipërfaqe në përdhese 101.60m².

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
 - Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore.
 - Informata mbi Projektuesin.
 - Informata mbi Kontraktuesin.
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
 - Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore.
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit.
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent.
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit.
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit.
 - Librin dhe ditarine ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur.
 - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për çertifikatë të përdorimit.
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit në paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore.
- Duhet të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore. Në rast të mos respektimit të Lejes së ndërtimit si dhe në çdo parregullsi që haset në teren inspektori përgjegjës duhet të njoftoj me shkrim organin kompetent në mënyrë që të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore. Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, Investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftoj organet komunale.
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi.
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0.1)

metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore.

- o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore dhe pranimit teknik të të gjitha fazave, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi Milazim Jashar Zeqiri nga fshati Mushtisht, përmes kërkesës 07Nr.350/73121 datë 04.12.2025, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim objekt për shërbime shëndetsore dhe shoqërore me etazhitet P+0, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Akvendimin mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.630/350-62243 datë 27.10.2025 (kopje),
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.185/2025, datë 29.10.2025 lëshuar nga Kompania Regjionale për Mbeturina "ECO-REGJIONI"- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Përgjigje në kërkesë nga Kompania regjionale e ujësjellësit dhe kanalizimit KRU "Hidroregjioni Jugor"- Sh.A.-Prizren nr. 4692 datë 19.11.2025,
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor-nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.420 datë 03.11.2025,
- Pëlqim parimor nga KEDS-SH.A, Nr.945, datë 27.11.2025,
- Pëlqim nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent nr.0004803/25 datë 17.11.2025,
- Përgjigje në kërkesë për kyçjen në rrugë nr. 11194 datë 04.12.2025 nga MMPHI (Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve),
- Kordinatat e vendosjes së objektit sipas skicës së terenit me numër të lëndës 265/2025 të datës 15.10.2025 të punuar nga gjeodeti i licensuar Adriatik Fetiu,
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike,
- Kopje e planit dhe certifikata e pronësisë,
- Kopje e dokumentit Identifikues,
- Dëshmi për pagesën e taksës sipas njoftimit 07Nr.10/350-73121 datë 22.01.2026, taksa administrative 284.48€ sipas faturës komunale nr.001490 e paguar në Banka për Biznes SH.A me datë 23.01.2026.

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030, 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis – Komuna Suharekë

Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.33/350-73121 datë 09.02.2026

Vendimi i dërgohet: Parashtruesit të kërkesës; Inspektoratit të Komunës; DSHPJK-së; Dosjes së DUPM-së

Drejtori i Drejtorisë:

Visar KUCI

Faqe 4 nga 4

Adresa: Objekti i Kuvendit Komunal, Kati i Parë, nr: 231, Suharekë – Kosovë Telefon: 020 271 318
www.komuna-suhareke.org, E-mail: urbanizmisuhareke@rks-gov.net

